



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:199737
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05559620

C.nr.2533/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr.M. nga P., me adresë në lagjen D., hyrja...nr..., të cilin e përfaqëson avokat A.F. sipas autorizimit nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas, kundër të paditurës K.P., të cilën e përfaqëson D.Gj. sipas autorizimit, me objekt kontesti: kompensim dëmi, vlera e kontestit 9,049.00 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 20.03.2024 në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, ndërsa me datë 05.04.2024, e përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Rr.M. nga P. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura K.P. që në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar në dyshemetë prej parketit, dyert, suvatimin e mureve të interierit të brendshëm deri në ngjyrosje dhe tavanit në banesën e tij në lagjen D. në P., t'ia paguaj shumën prej 9,049.00 euro me kamatë ligjore 8 % nga momenti i paraqitjes së padisë.

II. Secila palë i bartë për vete shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi Rr.M. nga P., me adresë në lagjen D., hyrja...nr..., me datën 28.10.2015 ka paraqitur padi në këtë Gjykatë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura K.P. që në emër të kompensimit të dëmit material, t'ia paguaj shumën prej 6,592.00 euro me kamatë 3.5% nga dita e shkaktimit të dëmit dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga nxjerrja e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Përmes padisë, paditësi ka theksuar se me datën 3 Gusht 2015 nga të reshurat atmosferike, shiut rrëmbyes, uji i përzier edhe me ujërat e kanalizimit, përmes gypave të kanalizimit ka depërtuar në banesë, duke i shkaktuar një dëm të papërballueshëm dhe atë sipas përlllogaritjes së tij, arrin shumën prej 6,592.00 euro. Më tutje, ka shtuar se sipas specifikimit të konstatuar nga Komisioni i Kuvendit Komunal, në banesën e tij janë shkaktuar këto dëme: tri dhoma, të gjitha muret, parketi në tërë sipërfaqen e banesës 62 metra, komplet kuzhina me pajisjet si frigoriferi, shporetë elektrik, makina e rrobave, makina e enëve, pesë tepihë si dhe dhoma e pritjes.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se paditësit nuk i është shkaktuar asnjë dëm me fajin e të paditurës, në këtë rast mungon edhe lidhja shkakore në mes të veprimit apo mos veprimit dhe dëmit të pësuar, kurse paditësi nuk e ka argumentuar e as provuar përgjegjësinë e të paditurës lidhur me këtë dëm. Ka shtuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me dëm të shkaktuar nga fuqia madhore, e të cilat dëme janë të përjashtuara nga përgjegjësia. Mbi këtë bazë gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit të refuzoj si të pa bazuar.

Në seancën përgatitore dhe në seancën e shqyrtimit kryesor i autorizuari i paditësit ka qëndruar prapa padisë, duke shtuar se banesa e cila gjendet në katin përdhes i është vërsuar, dhe ky vërshim ka ndodhur për shkak të ujërave të zeza, dhe se lidhur me këtë gjykatës në cilësi të provave i ka dorëzuar fotot e banesës. Po ashtu, e ka precizuar edhe kërkesën e padisë duke kërkuar në emër të kompensimit të dëmit shumë në lartësi prej 9,049.00 euro se bashku me kamatë ligjore. Ndërsa, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit dhe fakti se i njëjti me datën 03.08.2015 ka pësuar dëm në banesën e tij, dhe i njëjti dëm është konstatuar edhe nga ekspertiza e ndërtimtarisë. Më tutje, ka shtuar se e paditura në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 17 pika f është e obliguar që të mirëmbaj kanalizimin, drenazhimin dhe trajtimin e ujërave të atmosferike e që kjo mbështetet edhe në nenin 136 të LMD-së me të cilin janë përcaktuar bazat e përgjegjësisë së dëmit. Mbi këtë bazë, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e precizuar e paditësit të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, për pesë seanca gjyqësore nga 135.00 euro për secilën seancë apo shumë prej 675.00 euro, si dhe në emër të ekspertizës së ndërtimtarisë shumë prej 150.00 euro.

I autorizuari i të paditurës në seancën përgatitore dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar kërkesën e paditësit si të pa bazuar në fakte dhe të pa mbështetur në prova materiale. Ka shtuar se dëmi është shkaktuar si pasojë e fuqisë madhore, dhe në këtë rast nuk arrihet të vërtetohet përgjegjësia e të paditurës për dëmin e shkaktuar, sepse mungon lidhja shkakore në mes të veprimit apo mos veprimit dhe dëmit të shkaktuar. Ka shtuar se nga paraqitja e padisë e deri me tani kanë kaluar tetë vite dhe se asnjëherë nuk është bërë sigurimi i provës dhe rrjedhimisht nuk mund të behët edhe vërtetimi i gjendjes faktike, me ç' rast nuk mund të behët edhe argumentimi i kërkesëpadisë së paditësit në mungesë të tyre. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga administrimi i provave rezulton fakti se padia dhe kërkesa e saj është e pa themeltë për shkak se rezulton se i njëjti ka pësuar dëm si pasojë e reshjeve të mëdha atmosferike, respektivisht fuqisë madhore të cilat janë të pa parashikueshme dhe nuk kanë mund të parashikohen e as të mënjanoohen, andaj kjo përgjegjësi nuk mund t'i mëveshët të paditurës, dhe atë duke u bazuar në nenin 158 të LMD-së. Rrjedhimisht, paditësi nuk e ka argumentuar në asnjë mënyrë lidhjen kauzale të veprimeve ose mos veprimeve të paditurës në raport me dëmet e shkaktuara. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesën e saj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike kontestimore, gjykata sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat si në vijim: kërkesa e paditësit drejtuar K.P. me datë 11.09.2015, konstatimi i datës 10.08.2015 i K.P., shikimi i fotove në shkresa të lëndës, ekspertizën e ndërtimtarisë e datës 28.01.2023, njoftimi i ekspertës së aktuaristikës i datës 21.08.2023 dhe njoftimi i ekspertës së aktuaristikës i datës 14.02.2024.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara si me lartë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tani e tutje LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike kontestimore, si çështje kontestuese paraqitet përgjegjësia e të paditurës lidhur me dëmin e shkaktuar në banesën e paditësit si pasojë e të reshurave atmosferike, shiut rrëmbyes, ujit të përzier edhe me ujërat e kanalizimit, përmes gypave të kanalizimit, i cili sipas pretendimeve të paditësit ka depërtuar në banesën e tij, përkatësisht nëse dëmi është shkaktuar si pasojë e veprimit apo mos veprimit të të paditurës.

Nga kërkesa e paditësit drejtuar të paditurës përkatësisht K.P. me datë 11.09.2015, gjykata konstaton se paditësi ka kërkuar nga e paditura të dal në vend ngjarje dhe të bëjë vlerësimin e dëmit të shkaktuar, dhe njëkohësisht ka kërkuar edhe kompensimin e dëmit në emër të dëmit shkaktuar nga vërshimi i ujit në banesën e tij.

Përmes konstatimit të datës 10.08.2015 i kryer nga Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim përkatësisht nga inspektorët për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të cilët funksionon në kuadër të K.P. respektivisht të paditurës, gjykata konstaton se sipas kërkesës së paditësit inspektorët kanë dal në vend ngjarje dhe kanë konstatuar se pas reshjeve të shiut me datë 03.08.2015 në banesën e paditësit ka depërtuar uji dhe ka shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe atë në tri dhoma muret vertikale, dyshemeja në 3 dhoma, kuzhinë, frigoriferi, lavatriqja e rrobave, 5 tepihë si dhe gardëroba në dy ormanë. Kurse në fund të këtij raporti, është e konstatuar se inspektorët për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera kanë konstatuar gjendjen faktike, ndërsa nuk kanë bërë analizën financiare të dëmit të shkaktuar.

Nga ekspertiza e ndërtimtarisë e datës 28.01.2023, e hartuar nga eksperti gjyqësor L.D., dhe deklarimi i tij në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i njëjti ka deklaruar se me rastin e daljes në vend shikim banesa ka qenë e renovuar tërësisht, dhe mendimin e tij në raport me vlerën e dëmit të shkaktuar, me rastin e hartimit të ekspertizës e ka bazuar mbi fotot e kohës dhe dokumentet zyrtare të K.P.. I njëjti përmes ekspertizës ka shtuar se, nuk ka fakte të mbetura si prova në vend shikim nga rrjedhja e ujit dhe faktet tashmë janë të humbura, sendet e dëmtuara janë gjuajtur në deponi dhe të gjitha orenditë dhe dyshemetë nga parketi janë ngjyrosur dhe rregulluar. Eksperti ka theksuar se mendimin e tij e ka bazuar mbi krahasimin e fotove të cilat gjenden në shkresa të lëndës. Lidhur me këtë, në ekspertizë ka theksuar se fotot e dëmeve të shkaktuara të dyshemeve, të mureve të dëmtuara pas një rehabilitimi dhe investimi në banim nga ana e paditësit nuk janë shumë të dukshme pasi që ka ndërruar krejt gjendja në kuptimin pozitiv të rregullimit të banesës. Më tutje, ka shtuar se, fotot në shkresa të lëndës dhe konstatimi i Inspektoratit Komunal dhe disa

dëshmitarë japin fakte dhe prova se banesën e ka vërsuar uji. Ndërsa, në raport me lartësinë e dëmit të shkaktuar, eksperti mbi bazën e të lartcekurave ka arritur në përfundim se vlera e dëmit është në lartësi prej 9,049.00 euro.

Përmes njoftimit të ekspertes së aktuaristikës G.Sh. i datës 21.08.2023, gjykata konstatoj se ekspertja nuk ka arritur të hartoj ekspertizën për shkak të mungesës së provave apo dëshmimeve përmes të cilave do të konstatohej vlera e sendeve, për të cilat paditësi pretendon se i janë dëmtuar si pasojë e vërshimeve nga uji.

Ndërsa, nga njoftimi i ekspertes së aktuaristikës V.M. i datës 14.02.2024, gjykata konstatoj se sikurse nga njoftimi paraprak i ekspertes, edhe ekspertja tjetër kishte deklaruar se si pasojë e mungesës së provave e ka të pamundur të japë mendim profesional në raport me vlerën e sendeve të dëmtuara.

Në raport me pretendimet e lartcekura, neni 136 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, parasheh se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë të kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, ndërsa me nenin 140 të këtij Ligji përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia.”*

Gjykata vlerësoi se me provat e administruara në këtë çështje juridike kontestimore, nuk u vërtetua bazueshmëria e kërkesëpadisë. Provat të cilat u administruan nga ana e gjykatës sipas propozimit të palës paditëse, gjykata i vlerësoi si të pamjaftueshme dhe jo bindëse në kuptimin e vërtetimit të fakteve vendimtare mbi bazën e të cilave gjykata do të vendoste lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Në lidhshmëri me këtë, gjykata pas vlerësimit të mendimit dhe konstatimit të ekspertit të ndërtimtarisë, gjeti si i njëjti nuk ka arritur të ofrojë të dhëna të mjaftueshme për të konstatuar përgjegjësinë e të paditurës lidhur me dëmin e shkaktuar si pasojë e vërshimeve dhe depërtimit të ujit në banesën e paditësit, ngase eksperti mendimin dhe konstatimin e tij e ka dhënë vetëm mbi bazën e vlerësimit dhe shiqimit të fotografive të ofruara nga paditësi dhe deklaratat e dëshmitarëve me rastin e daljes në vend shikim, dhe atë afërsisht 8 vite pas kohës që pretendohet së ka ndodhur shkaktimi i dëmit, mirëpo këto të dhëna sipas vlerësimit të gjykatës ishin të pamjaftueshme për të konstatuar përgjegjësinë e të paditurës. Njëkohësisht, gjykata i vlerësoj edhe njoftimet e ekspertëve të aktuaristikës të cilat kanë arritur në përfundime të njëjta, lidhur me pamundësinë e hartimit të ekspertizës për të përcaktuar lartësinë e dëmit në raport me pretendimin e paditësit, sa i përket sendeve të dëmtuara nga vërshimi i ujit.

Gjykata vlerëson se në rastet kur pretendohet shkaktimi i dëmit duhet të plotësohen në mënyrë komulative disa kushte, dhe atë: a) duhet të ekzistoj dëmi i shkaktuar, b) dëmi të shkaktohet si pasojë e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) duhet të ekzistoj faji, dhe d) duhet të ekzistoj lidhja kauzale në mes të veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të shkaktuar. Rrjedhimisht, në rastin konkret kontestues nuk është përmbushur elementi i lidhjes kauzale apo shkakore, që do të tërhiqte pas vetes edhe fajin. Për me shumë, lidhja kauzale paraqet raportin e ndërsjellë, në mes të veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Në lidhshmëri me këtë, lidhja kauzale duhet të jetë e atillë që duhet të

dëshmojë për ngjarjen e cila sigurt është shkaktuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit të të paditurës. Përfundimisht, në këtë proces kontestimor, pala paditëse nuk arriti të argumentojë apo provoj se me veprimet apo mosveprimet e të paditurës, është shkaktuar dëmi apo pasoja, ashtu siç përcaktohet me nenin 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. E në lidhshmëri me të provuarit, neni 319 paragraf 1 i LPK-së, parasheh se secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, për çka paditësi në rastin konkret, në mungesë të ekspertizave përkatëse nuk arriti të provoj se e paditura bartë përgjegjësi për dëmin e pretenduar.

Po ashtu, gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditësit, për nxjerrjen e provës nga eksperti i aktuaristikës, kjo për faktin se gjykata paraprakisht kishte aprovuar dy propozime të autorizuarit të paditësit për nxjerrjen e një ekspertize të tillë, dhe të dy ekspertet kishin arritur në përfundime të njëjta, sipas të cilëve në mungesë të provave e kanë të pa mundur të hartojnë ekspertizën. Njëkohësisht, i autorizuari i paditësit, kishte propozuar nxjerrjen e provës nga një ekspert i arkitekturës, i cili sipas tij do të kalkulonte lartësinë e dëmit të pretenduar të paditësit, mirëpo, gjykata këtë propozim e refuzoj, për faktin se kalkulimi i dëmit nuk hynë në kompetencën apo fushëveprimin e arkitektit.

Gjithashtu, gjykata vlerësoj se paditësi nuk i ka përdorë mundësitë ligjore për të siguruar provën menjëherë, mbi dëmet e mundshme të shkaktuara me rastin e vërshimit të ujit në banesën e tij, ashtu siç përcaktohet me nenin 379 e tutje deri tek neni 385 i LPK-së. Ndërsa, pas ndryshimit të gjendjes faktike, me ndërrimin e gjendjes së banesës, fakt që nuk është kontestues nga deklaratimet e palëve, është e pa mundur të jepet një mendim objektiv nga cili do ekspert, lidhur me rrethanat e ndodhjes së shkaktimit të dëmit të pretenduar dhe vërtetimin e përgjegjësive të të paditurës në shkaktimin e dëmit. Me çka, gjykata vlerëson se në mungesë të provës së siguruar, dhe në mungesë të provave të tjera, paditësi nuk ka mundur të argumenton të drejtën e tij dhe detyrimin e të paditurës për kompensimin e dëmit.

Për me shumë, edhe pse paditësi nuk arriti të argumentoj bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata në raport pretendimet e paditësit, i cili ka deklaruar se dëmi i është shkaktuar si pasojë e të reshurave atmosferike, shiut rrëmbyes, ujit të përzier edhe me ujërat e kanalizimit, përmes gypave të kanalizimit, i cili ka depërtuar në banesë, e vlerësoj të drejtën materiale, lidhur përgjegjësinë e të paditurës në rastin konkret.

Lidhur me këtë, e mbi bazën e pretendimeve të vet paditësit, gjykata vlerëson se duhet të zbatohet neni 158 paragraf 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili parasheh: *“Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet.”* Bazuar në këtë dispozitë, gjykata vlerëson se e paditura nuk bartë përgjegjësi për kompensimin e dëmit në raport me paditësin, kjo për faktin se, zotëruesi, në këtë rast e paditura, do të lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit apo veprimtarisë dhe efekti i atij shkak nuk ka mundur të parashikohet, të mënjanohet dhe të evitohet. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me fuqi madhore, e cila nënkuptohen të gjitha dukuritë dhe ndodhitë e jashtme, të cilat nuk kanë mundur të parashikohen, të mënjanohen apo të evitohen, e të cilat kanë ndikuar në shkaktimin e dëmit. Në lidhshmëri me këtë, dispozita ligjore e lartcekur ka paraparë se në raste të caktuara, duke u

bazuar në rrethana të veçanta, të lirohet nga përgjegjësia, e në këto rrethana bënë pjesë edhe fuqia madhore. Kjo për faktin se, e paditura nuk kishte asnjë mundësi të parashikoj, të mënjanoj apo të evitoj të reshurat atmosferike dhe shiun rrëmbyes, i cili ka depërtuar në banesën e paditësit. Se dëmi i pretenduar nga paditësi në banesën e tij, është shkaktuar nga të reshurat atmosferike dhe shiun rrëmbyes, nuk ishte kontestuese as për paditësin, e po ashtu, e njëjta vërtetohet edhe nga konstatimi i datës 10.08.2015 i kryer nga Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim, përkatësisht nga inspektorët për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të cilët funksionon në kuadër të K.P.. Njëkohësisht, pala paditëse nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme konstatimin e lartcekur, lidhur me atë se nëse e paditura ka pas mundësi me mënjano një dëm të cilin e pretendon, si dëm i shkaktuar me veprim ose mos veprim nga e paditura, përkatësisht nga gypat e kanalizimit, e ku pala paditëse ka pas mundësi gjatë gjithë procedurës të argumentoj me fakte apo prova se gypat si pasojë e të cilëve pretendon se është shkaktuar dëmi, kanë qenë shkaktar të dëmit të pretenduar.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, e në përputhje me paragrafin 2 të nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, gjykata përmes provave të administruara arriti të vërtetoj gjendjen faktike, dhe gjeti se nuk është arritur të konstatohet se e paditura mban përgjegjësi për shkaktimin e dëmit, për çka vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata kishte parasysh edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, po ashtu, edhe provat e tjera, të cilat janë administruar në shqyrtim kryesor, mirëpo, të njëjtat nuk ishin relevante dhe nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese.

Në raport me shpenzimet, gjykata vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, ku secila palë të i bartë shpenzimet e veta procedurale, dhe atë duke u bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së, duke marr parasysh suksesin e palëve në procedurë, ku pala paditëse i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe i ka specifikuar të njëjtat, mirëpo e njëjta e ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, për çka edhe gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e neneve 142 dhe 143 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2533/2015, datë 05.04.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.